

**VENDIM**  
**Nr. 426, datë 15.5.2013**

**PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT KOMBËTAR  
PËR NOMENKLATURËN<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.8 datë 12.1.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12/2 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, për kryerjen e përditësimit, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat europiane dhe ndërkombëtare.

2. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

<i>a) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</i>	<i>1;</i>
<i>b) Ministria e Brendshme</i>	<i>1;</i>
<i>c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	<i>1;</i>
<i>c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</i>	<i>1;</i>
<i>d) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</i>	<i>1;</i>
<i>dh) Ministria e Drejtësisë</i>	<i>1;</i>
<i>e) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</i>	<i>1;</i>
<i>ë) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	<i>1;</i>
<i>f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</i>	<i>1;</i>
<i>g) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes</i>	<i>1;</i>
<i>gj) Banka e Shqipërisë</i>	<i>1;</i>
<i>h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit</i>	<i>1;</i>
<i>i) Drejtorja e Përgjithshme e Doganave</i>	<i>1;</i>
<i>j) Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve</i>	<i>1;</i>
<i>ke) Instituti i Sigurimeve Shoqërore</i>	<i>1;</i>
<i>l) Qendra Kombëtare e Biznesit</i>	<i>1;</i>
<i>ll) INSTAT-i</i>	<i>2.</i>

3. Përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të Komisionit, caktohen nga titullarët e institucioneve, sipas kriterëve dhe kërkesave të paraqitura nga Instituti i Statistikave dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve njoftojnë INSTAT-in.

4. Për përgatitjen e mbledhjeve dhe koordinimin e çështjeve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, krijohet sekretariati i Komisionit, me përbërje specialistë të Institutit të

---

<sup>1</sup> VKM nr. 426, datë 15.5.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.90, 30 maj 2013.

VKM nr. nr 8 datë 12.1.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr .3, 18 janar 2018

Statistikave. Rregullat për funksionimin e sekretariatit përcaktohen me rregulloren e miratuar nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën.

5. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mblidhet me thirrjen e kryetarit. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 25.8.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

6. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mund të ngrejë grupe pune, sipas fushave dhe nevojave të tij, me përbërje nga të gjitha institucionet e përfshira në Komision ose një pjesë të tyre. Rregullat për funksionimin e këtyre grupeve dhe shkallën e tyre të përgjegjësisë përcaktohen me vendim të veçantë të këtij Komisioni.

7. Nomenklaturat e miratuara paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

8. Vendimi nr. 327, datë 18.7.1994 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zbatimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Instituti i Statistikave dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**